



ДРЖАВЕН ЗАВОД ЗА РЕВИЗИЈА
ENTI SHETËROR I REVIZIONIT
STATE AUDIT OFFICE

Abstrakti i raportit përfundimtar i revizionit

Subjektet kyçe të përfshira në raportin e revizionit: Institucioni i Shëndetit Publik Klinika Universitare për Radioterapi dhe Onkologji Shkup

Lënda e revizionit:

Revizioni i raporteve financiare bashkë me revizionin e pajtueshmërisë së llogarisë për mjetet nga Fondi - 737

Qëllimi i revizionit: Nëse raporti financiar është i liruar nga paraqitjet e gabuara materialisht dhe nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet në to janë në pajtim me rregullativën ligjore.


Gjendjet kyçe të konstatuara:

- dobësi në planifikimin, realizimin dhe kontrollin e kompensimit të kushtëzuar për prokurimin e terapisë biologjike dhe mungesa e protokolleve/udhëzimeve mjekësore me të cilët do të vendosë rregulla dhe do të përcaktojë kriteret për kyçjen e pacientëve në terapi biologjike;
- regjistrimi i mjeteve dhe detyrimeve nuk është zbatuar në tërësi;
- janë marrë detyrime mbi buxhetin e miratuar për vitin 2021, ndërsa gjendja e detyrimeve të papaguara me datë 31.12.2021 arrin 647.526 mijë denarë;
- shpenzimi i terapisë biologjike në vlerë prej 649,141 mijë denarë i realizuar në periudhën prej mujit 04/2021 deri në mujin 12/2021 është evidentuar në fund të vitit, nga arsyeja se barnat janë blerë me revers dhe për të njëjtit nuk është formuar çmimi;
- në një pjesë të procedurave të zbatuara për prokurime publike konstatuam zbatimin joadekuat të Ligjit për prokurime publike.

Rekomandimet kyçe:

- terapia biologjike të prokurohet në kuadër të buxhetit të siguruar pas një kontrate të lidhur më parë për prokurim publik dhe e njëjta të përcaktohet dhe t'u caktohet pacientëve sipas mendimit paraprak të kolegjiut profesional;
- zbatimi i plotë i regjistrimit të rregullt vjetor;
- marrja e detyrimeve në kuadër të buxhetit të miratuar si dhe pagesa e rregullt e tyre;
- evidentimi në kohë i shpenzimit të terapisë biologjike dhe
- sigurimi i zbatimit konsekuent i dispozitave të Ligjit për prokurime publike.

Mendimi i dhënë/konkluzioni*:



Mendim të pavolitshëm në lidhje me vërtetësinë dhe objektivitetin e raporteve financiare dhe për pajtueshmërinë e transaksioneve financiare me rregullativën ligjore relevante për vitin 2021

Çështje tjera: Revizioni njofton se:

- në procedurat e servisimit të pajisjeve për të cilat operatorët ekonomikë kanë pozicion monopol/të drejtë ekskluzive, lidhen kontrata për shërbim të plotë, ku nuk ka mundësi të krahasohet/përcaktohet realiteti i fondeve të paguara në raport me vëllimin e shërbimeve të kryera.
- një përsheptues linear i blerë nga Ministria, i cili deri në ditën e kryerjes së revizionit nuk është vënë në përdorim, nga arsyeja se Klinika nuk ka hapësirë të përshtatshme në të cilën mund të instalohet.

Vërejtjet e marra të draft-raportit: Nuk janë marrë vërejtje për Draft-Raportin e revizorit të autorizuar shtetëror numër 25-217/2 nga 06.02.2023.

* pozitive, me rezervë, të pavolitshëm, të përmbytur